


PRIZENI
A. D. C. R. Q. T. K. S. E
23.06.2017

REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRY OF CULTURE, YOUTH & SPORTS
Prizren Institute for the Protection of Monuments
Nr. 130/4
Est. Da. 23.06.2017



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

*Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit -Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta-
Ministry of Culture, Youth & Sports*

**Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturorë / Regionalni Centar za Kulturno Nasledje / Bölge
Kültürel Miras Merkezi / Regional Center for Cultural Heritage
Prizren**

DATË/A:	23.06.2017
REFERENC-Ë:	130/4
PËR/ZA/TO:	Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
GA/OD/FROM:	Samir Hoxha - Drejtor i QRTK-së Prizren
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Rekomandimi i Komisionit të IKMM-së Prishtinë

Po ju dërgojmë Rekomandimin e Komisionit të IKMM-së për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese-Konservuese të Trashëgimisë Kulturorë nr.12/2017 të dt.26.05.2017 për lëndën e DUPH Prizren Nr. 04-353-47456 për ndërtimin e infrastrukturës për qasje në Kalanë e Prizrenit.

Lëndës ia bashkangjesim kopjen e Rekomandimit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta – Ministry of Culture, Youth and Sports
Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve / Kosovo Institute for Protection of Monuments
/ Institut Kosova za Zastitu Spomenika

REPUBLIKA E KOSOVËS
INSTITUTI ZA ZASTITU SPOMENIKA / INSTITUT KOSOVA
DE KOSOVO INSTITUTE FOR CULTURAL MONUMENT PROTECTION

317 22.06.2017
PRISHTINE

DATE/A:	26.05.2017
REFERENC-Ë:	12/2017 – Takimi i dymbëdhjetë
PËR/ZA/TO:	Z. Agim GËRGURI – U.D. Drejtor i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve.
CC:	Z. Bislim BİSLIMI – Udhëheqës i Divizionit për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit / DL – MKRS, anëtar i Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Projekteve dhe Kërkesave Restauruese Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM; Znj. Zana LLONÇARI OSMANI – Zyrtare e Lartë në Departamentin e Trashëgimisë Kulturore – MKRS, anëtare e Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Projekteve dhe Kërkesave Restauruese Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM;
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Znj. Teuta SELMANAJ – Zyrtare Ligjore në IKMM, përgjegjëse për mbështetjen administrative të punës së Komisionit.
NGA/OD/FROM:	Znj. Merita AUGUSTININRECAJ – Kryesuese e Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Projekteve dhe Kërkesave Restauruese Konservuese të Trashëgimisë Kulturore.
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Rekomandimet e Komisionit, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesave / projekteve: Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore – Mitrovicë, Gjilan dhe Pejë.

I nderuar Drejtor z. Gërguri,

Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Projekteve dhe Kërkesave Restauruese Konservuese të Trashëgimisë Kulturore (në tekstin e mëtejshëm Komisioni) i emëruar me Vendimin Nr. 01/2016 të datës 13.04.2016, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin tjetër Nr. 52/2016 të datës 04.10.2016 me Nr. të protokollit 376 ka zhvilluar takimin e dymbëdhjetë (12) punues me datë 17.05.2017, ku janë shqyrtuar kërkesat dhe projektet e Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore (QRTK) – Prizren dhe Pejë. Janë dhënë rekomandimet si në vijim:

kërkesë për ndërtimin e objektit - shtëpi individuale për banim, etazhiteti S+P+1 (nr. Parcelës 03714-2) Përmbajtje:

1. Lënda: Kërkesë nga Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore –Prizren për shqyrtimin dhe vlerësimin e lëndës: Kërkesë për aprovim të projektit - Ndërtimi i infrastrukturës për çasje në Kalanë e Prizrenit”
2. Lënda: Kërkesë nga Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore – Prizren për shqyrtimin dhe vlerësimin e lëndës: “kërkesë për ndërtimin e objektit – shtëpi individuale për banim me lokal afarist në ngastrën kadastrale 02518 – 1 – 397 – 0”.
3. Lënda: Kërkesë nga Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore – Prizren për shqyrtimin dhe vlerësimin e lëndës: “kërkesë për aprovimin e projektit mbindërtim i nënkulmit në ngastrën kadastrale me Nr. 1899 – 1”.
4. Lënda: Kërkesë nga Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore – Prizren për shqyrtimin dhe vlerësimin e lëndës: “kërkesë për aprovimin e projektit – ndërtimi i objektit – shtëpi individuale për banim në ngastrën kadastrale 03714 – 2”.
5. Lënda: Kërkesë nga Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore –Prishtinë për shqyrtimin dhe vlerësimin e lëndës “kërkesë për aprovimin e projektit – masa preventive intervenime emergjente në momentet e trashëgimisë kulturore, konkretisht në momentin e njohur si “Shtëpi banimi Sali Safqi” e cila gjendet në zonen historike – qyteti i vjetër në ngastrën kadastrale Nr. 9 P-71914059-05615-2 .

Rreth kërkesës Nr. 1. QRTK –Prizren

1. Drejtorja e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapsinor (DUPH) në Prizren ka parashtruar kërkesë për ndërtimin e infrastrukturës për çasje në Kala të Prizrenit. Për këtë qëllim Komuna e Prizrenit ka formuar edhe një komision për caktimin e kushteve për hartimin e projektit Ideor, i cili komision përmes Komunes së Prizrenit ka kërkuar nga IAK të jep kushtet e përgjithshme që duhet inkorporuar në hartimin e projektit. Në projektin e prezentuar shihet se infrastruktura për ngjitjen në kala bëhet përmes binarëve, respektivisht kabinës lëvizëse që është vendosur në pjesën veri-lindore rreze kalasë. Pikënisja është planifikuar të bëhet nga lagja e Marashit (e cila është monument nën mbrojtje si “kompleksi i Marashit”), ndërsa arritja bëhet në cepin verior të kalasë ku është planifikuar të ndërtohen edhe disa ndërtesa përcjellëse rekreative – hoteliere. Largësia e kësaj strukture është rreth 5 metra nga muri verior i kalasë.

Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM, pas shqyrtimit të lëndës, ka rekomanduar si më poshtë:

1. Refuzohet projekti ideor - Ndërtimi i infrastrukturës për çasje në Kalanë e Prizrenit, pasi që i njëjti është në kundërshtim me kushtet e përgjithshme të dhëna nga IAK – u, si dhe në kundërshtim me Ligjin Nr.02/L – 88 për Trashëgiminë Kulturore.

Rreth kërkesës Nr. 2. QRTK –Prizren: